

2020 Dita Botërore Pa Duhan (DBPD): Të mbrojmë rininë nga manipulimet e industrisë dhe parandalojmë përdorimin e duhanit dhe nikotinës prej tyre

MESAZHET KYÇE:

PËRMBLEDHJE

- 1. Çdo vit, produktet e duhanit vrasin më shumë se 8 milionë njerëz, nga të cilët mbi 1 milion vdesin prej ekspozimit ndaj tymosjes pasive.**
- 2. Rajoni evropian i OBSH-së ka prevalencën më të lartë të përdorimit të duhanit në botë, çka sjell një barrë të rëndë shëndetësore dhe ekonomike, si dhe bëhet shtysë për pabarazi më të mëdha shëndetësore.** Për vitin 2018, OBSH-ja vlerëson se në këtë Rajon përdorues të duhanit ishin 186 milionë persona, nga të cilat 119 milionë ishin burra dhe 67 milionë gra. Për sa i përket përdorimit të duhanit nga rinia evropiane, OBSH-ja vlerëson se në grupmoshën 13-15 vjeç, 14% e djemve (ose 2.2 milionë) dhe 12% e vajzave (1.7 milion) janë aktualisht përdorues të duhanit.
- 3. Përdorimi i cigareve elektronike nga fëmijët dhe adoleshentët më së paku i dyfishon gjasat që ata të tymosin cigare më vonë në jetë.** Shkalla e përdorimit të cigareve elektronike mes rinisë të Rajonit është në rritje. Anketat kombëtare tregojnë se kjo shkallë shkon nga 0.9% në Slloveni (2014) në 23.4% në Poloni (2016). Vendet që përmes anketimeve kanë mbledhur të paktën dy herë informacion mbi përdorimin e cigareve elektronike, vëzhgojnë rritje të përdorimit të cigareve elektronike me kalimin e kohës, si tek djemtë ashtu edhe tek vajzat.
- 4. Përdorimi i duhanit është përgjegjës për 25% të të gjitha vdekjeve nga kanceri në nivel global.** Në rajonin evropian pothuajse 9 nga 10 kancerët e mushkërive kanë të bëjnë me përdorimin e duhanit. Përdorimi i produkteve të nikotinës dhe duhanit rrit riskun e kancerit, sëmundjeve kardiovaskulare dhe pulmonare. Po ashtu, përdorimi i duhanit e rrit në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e vdekjes së parakohshme nga disa SJT, siç janë SKV-të, kanceri dhe sëmundjet respiratore, të cilat tek burrat shkaktojnë 25%, 41% dhe 63% të vdekjeve, dhe tek gratë 6%, 10% dhe 37% të vdekjeve.
- 5. Përdorimi i cigareve elektronike rrit riskun për sëmundje të zemrës dhe çrregullime të mushkërive.** Nikotina në cigaret elektronike është një substancë që krijon varësi të lartë dhe mund të dëmtojë trurin në zhvillim të fëmijëve.
- 6. Tymosja me shisha është po aq e dëmshme sa format e tjera të përdorimit të duhanit.** Tymi i shishas është toksik. Ai përmban substanca që shkaktojnë kancer.
- 7. Fakti që nuk ka tym nuk do të thotë që është i padëmshëm.** Përtpypja e duhanit mund të shkaktojë kancer në gojë, humbjen e dhëmbëve, dhëmbë të nxirë, dhe sëmundje të mishrave të dhëmbëve.

INDUSTRIA E DUHANIT DHE TAKTIKAT E SAJ

8. Për të ruajtur fitimet, industrisë së duhanit dhe aktiviteteve të lidhura u duhet të gjejnë vazhdimisht konsumatorë të rinj për të zëvendësuar ata që vriten nga produktet e tyre. Kompanitë e duhanit shpenzuan mbi 8 miliardë në marketing dhe reklama, kurse bota humbi 8 milionë jetë nga shkaqet që lidhen me përdorimin e duhanit dhe ekspozimin ndaj tymosjes pasive.
9. Taktikat e industrisë së duhanit dhe aktiviteteve të lidhura për marketing mes fëmijëve dhe adoleshentëve përfshijnë:
 - Mbi 15,000 shije, shumica e të cilave janë tërheqëse për fëmijë dhe adoleshentë
 - Influencues dhe marketing në rrjete sociale
 - Evente dhe festa të sponsorizuara
 - Bursat shkollore
 - Dizajne elegante
 - Vendorsje të produkteve në media argëtuese
 - Mostra falas të produkteve
 - Shitja e cigareve një e nga një e bën varësinë më të përballueshme
 - Shitja e produkteve në nivelin e syve të fëmijëve
 - Vendorsja e produkteve dhe reklamave pranë shkollave

SYNIMET E FUSHATËS SË DBPD-SË PËR VITIN 2020

10. Ne duam të krijojmë një brez të lirë nga duhani dhe tymosja pasive, dhe vdekjet e sëmundjet që këto shkaktojnë.
11. Shkëputuni nga manipulimet e industrisë së duhanit dhe aktiviteteve të lidhura duke u edukuar mbi taktikat e tyre dhe dëmet e shkaktuara nga produktet e tyre.
12. Ne duam të theksojmë se duhanpirja është e shtrenjtë, dhe ju e paguani me pamjen dhe shëndetin tuaj. Shkakton frymë të keqe, dhëmbë të verdhë, rrudha në lëkurë, mushkëri të pashëndetshme dhe sistem të dobët imunitar.
13. I inkurajojmë të gjithë që të edukohen, të përhapin vetëdijesimin dhe të krijojnë një brez pa duhan.